

edhe sekuestrimi. Siç provohet nga akte e përfshira në fashikullin gjyqësor dhe u pasqyruar më lart në këtë vendim (shih pikën "B"), procedimi pasuror në lidhje me pasuritë e të ndjerit Kleidi (Klodian) Saliu dhe personave të lidhur me të, ka filluar përpara datës 26.02.2010, (kohë në të cilën përfundonte afati pesëvjeçar i lejuar nga neni 3/3 i ligjit për të kërkuar sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të dyshuara që rrjedhin nga veprimtaria kriminale apo përbëjnë produkt të tyre, në rastin kur personat e dyshuar kanë vdekur), dhe në të njëjtën datë (26.02.2010) është vendosur nga gjykata për krime të rënda, mbi kërkesën e organit të prokurorisë, sekuestroja mbi pronat e të dyshuarit dhe personave të lidhur me të (të paralindurit e tij – prindërit Abedin e Hasije Saliu).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, në bazë të nenit 466, geramat "a" & "b" të K.Pr.Civile,

V E N D O S I:

1.-Lënien në fuqi të vendimit nr. 01, datë 09.03.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në lidhje me:

a) Konfiskimin e pasurisë, pronë "truall", me sipërfaqe 500 m², ndodhur në zonën kadastrale nr. 3184, me nr. pasurie 8/17, volumi 8, faqja 59, me adresë "Rinia", Durrës, së bashku dhe me një objekt "Bar-Restorant", me sipërfaqe 130 m², i cili është ndërtuar mbi këtë sipërfaqe tokë truall, në emër të Abedin Nexhip Saliu;

b) Pushimin e gjykimit të kërkesës për konfiskimin e pasurive dhe heqjen e sekuestros së vendosur për pasuritë depozitë e kursimit me vlerë aktuale 1.226.518 (një milion dyqind e njëzet e gjashtë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) lekë dhe depozitë kursimi me vlerë aktuale 719.749 (shtatëqind e dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet e nëntë) lekë.

2.-Ndryshimin e këtij vendimi për pasuritë e tjera, si më poshtë:

- Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, për konfiskimin e pasurive:

i) Pronë "truall", me sipërfaqe prej 1.500 m², ndodhur në zonën kadastrale nr. 3184, pasuria me nr. 8/32, volumi, 9 faqja 26, ndodhur në adresën "Rinia", Durrës, në pronësi të Abedin Nexhip Saliu;

ii) Autoveturë tip "Benz", me targa DR 7491 C, me nr. shasie WDB123123 12402454 pronë e Abedin Nexhip Saliu;